



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 130 Prot

Tiranë, më 12, 07, 2012

VENDIM Nr. 213, datë 12.07.2012

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 12.07.2012, pasi shqyrtoi "Raportin përfundimtar mbi sondazhet arkeologjike të kryer në sheshin e ndërtimit me adresë: **Lagjja Nr. 16, Rruga "Vasil Kuqi", Durrës**, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik mbi bazën e kërkesës të Subjektit "**AFL GROUP**" sh.p.k.,

VENDOSI:

- I. Miratimin e raportit përfundimtar të sondazhit arkeologjik, të përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës për sheshin e ndërtimit të subjektit "**AFL GROUP**" sh.p.k, Lagjja Nr. 16, Rruga "Vasil Kuqi", Durrës.
- II. Kryerjen e gërmimit arkeologjik të shpëtimit nga një shoqëri private e liçencuar nga KKA për gërmime arkeologjike shpëtimi, nën mbikëqyrjen e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. ASHA të hartojë kontratën dhe konceptin e gërmimit që do të paraqiten për miratim në KKA.
- IV. Investitori bën përzgjedhjen e subjektit privat të liçencuar nga lista e subjekteve privatë të liçencuar nga KKA.



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

- V. Pas përzgjedhjes së subjektit privat të liçencuar, investitori njofton ASHA për marrjen e konfirmimit përfundimtar dhe fillimin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit.
- VI. Në përfundim të gërmimit të përgatitet dokumentacioni i plotë dhe raporti me rekomandimet përkatëse, i cili duhet të paraqitet për miratim në KKA.
- VII. Gjetjet arkeologjike të dala gjatë gërmimit arkeologjik të shpëtimit të depozitohen pranë DRKK Durrës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al